

Diplomohen Psaltët e Rinj



Që në vitet e para Kryepiskopi Anastas, krahas arsimimit teologjik u kujdes edhe për ringjallërimin e muzikës bizantine. Duke theksuar rolin e psaltëve si të hirshëm dhe për më tepër duke i cilësuar ashtu siç referojnë kanonet e kishës, si klerikë që shërbejnë jashtë hierores, u kujdes që kualifikimi i tyre të kryhej në mënyrë profesionale dhe me kushte bashkëkohore. Ai u kujdes për ngritjen në vitin 2012 të Shkollës së Muzikës Bizantine, në Tiranë, në Qendrën shpirtërore “Thavor”. Deri më sot më shumë se 50 studentë kanë përfunduar kursin e përditshëm 2-vjeçar.

Në 8 nëntor 2019, në fund të Liturgjisë Hyjnore kryepiskopi Anastas iu dorëzoi diplomat 6 psaltëve të rinj nga zona të ndryshme të Shqipërisë, që mbaruan shkollën. Fortlumturia e Tij foli për rëndësinë e psaltëve në Kishë dhe falënderoi drejtorin e shkollës, kryepsaltin Theodor Peci, për gjithë punën e bërë.

- Diplomohen Psaltët e Rinj -Që në vitet e para Kryepiskopi Anastas, krahas arsimimit teologjik u kujdes edhe për...

Geplaatst door [Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#) op [Maandag 9 december 2019](#)

orthodoxalbania.net